



Pranuar / Dërguar / Punëuar / Prodatur / Recevera / Delivered	12. 07. 2023	3	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SPMBICK	5175/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.735/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, me rastin e ankesës A.nr.735/2023 të datës 15.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, me adresë pune _____,

_____ kundër organit të punësimit-Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.715/2023 e datës 15.05.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Nëpunësi civil _____, i punësuar në Drejtorinë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në Komunën e Mitrovicës Jugore, me datë 15.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 07.12.2022 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore Komunës së Mitrovicës Jugore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës, ndërsa me datë 02.06.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 15.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ndryshimin dhe Plotësimin e Aktit të Emërimit i datës 28.12.2016; Aktin e emërimit të datës 20.10.2014; Kërkesën e ankuesit të datës 05.12.2022; Kërkesën e ankuesit të datës 11.09.2018; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Përgjigjen e Zyrës së Personalit të datës 07.12.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.05.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 02.06.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e ankuesit; Zarin postar të datës 30.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizimi i shpresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurës, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e palejuar*, sepse:

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi në bazë ndryshim plotësimit të akt emërimit të datës 28.12.2016 është emëruar "*Udhëheqës i Sektorit për Infrastrukturë Rrugore*" në Komunën e Mitrovicës Jugore. Tutje sipas shkresave, i njëjti më datë 11.09.2018 i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Mitrovicës Jugore duke kërkuar ngritjen e koeficientit nga 7.5 (shtat pikë pesë) në 9 (nëntë), ndërsa me datën 05.12.2022 përmes kërkesës me numër 01-120/04-0108506/22 drejtuar Zyrës së Personelit ka kërkuar nivelizimin e pagave për shefat e sektorëve ashtu që ka kërkuar që ti bëhet ngritja e koeficientit nga 7.5 (shtat pikë pesë) në 8.5 (tetë pikë pesë). Ndaj të njëjtës kërkesë Zyra e Personelit me datë 07.12.2022 ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se pozitat për udhëheqës të sektorëve janë shpallur dhe rekrutuar duke u bazuar në katalogun e titujve të vendeve të punës të cilat janë me koeficient 7.5 (shtatë pikë pesë).

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datën 12.12.2022 me të njëjtin objekt të ankesës kundër përgjigjes së datës 07.12.2022 të Zyrës së Personelit, ankesë e cila është regjistruar me numër A.nr.1157/2022 dhe ndaj të cilës Kolegji i Këshillit kishte marrë Vendimin me numër A.nr. 1157/2022 të datës 19.01.2023 për përfundim të procedurës administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të shkresave lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesit, konstatoi se Zyra e Personelit kishte dhënë përgjigje ankuesit me datën 07.12.2022, andaj pas analizimit të dispozitave të nenit 127 paragrafi 1 të Ligji Nr. 05/1 -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ e cila parasheh se : " 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ, 4. Ankesa kundrejt heshijes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ", Kolegji i Këshillit erdhi në përfundim se ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshill me datë 15.05.2023 kundër përgjigjes së Zyrës së Personelit të datës 07.12.2022 është e jashtëafatshme pasi që pala ankuese përgjigjen e kontestuar pohon se e ka pranuar me datë 07.12.2022, ndërsa në rrethanat e rastit konkret pavarësisht faktit që ankesa është përsëritur me këtë rast e njëjta është parashtruar edhe jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh të përcaktuara me dispozitat e kësaj dispozite.

Prandaj, në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa A.nr.735/2023 e datës 15.05.2023 e parashtruar nga ankuesi është e papranueshme në rastin konkret për shkak se e njëjta është parashtruar jashtë afatit kohore prej 30 ditësh sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 127 paragrafi 1 të Ligji Nr. 05/1 -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ.

Kështu që, duke u mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.735/2023

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetari i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës Jugore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

